


Tregtia e jashtme e mallrave

Nëntor 2019

Tiranë, më 17 Dhjetor 2019: Në Nëntor 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u ulur me 9,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 8,6 %, në krahasim me Tetor 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 53 mld lekë, duke u ulur me 5,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 10,8 %, në krahasim me Tetor 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u ulur me 2,7 %, krahasuar me Nëntor 2018 dhe 12,6 %, në krahasim me Tetor 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 277 mld lekë, duke u ulur me 4,1 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 593 mld lekë, duke u rritur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 317 mld lekë, duke u rritur me 8,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 9,1 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -5,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,5 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -2,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,8 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,2 pikë përqindje.

Për publikim 17/12/2019

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2019 (p.p.)




Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori janë ulur me -4,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,1 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,0 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 5,8%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -3,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me +0,6 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,5 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2019 (p.p.)



Si njëmbëdhjetëmujor, importet janë rritur me 2,1 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,8 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,5 pikë përqindje. “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,6 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Nëntor 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2018 janë: Spanja (37,8 %), Gjermania (0,1 %), dhe Greqia (1,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-12,8 %), Kosova (-9,6 %) dhe Kina (-10,0 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (10,6 %), Gjermania (5,2 %), dhe Kina (11,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-3,6 %), Spanja (-9,2 %) dhe Greqi (-4,0 %).

Në muajin Nëntor 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Nëntor 2018 janë: Turqia (+28,2 %), Zvicra (+58,4 %), dhe Polonia (+12,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-5,1 %), Kina (-0,8 %) dhe Gjermania (-5,8 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (12,9 %), Kina (12,9 %) dhe Greqia (7,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-5,9 %), Gjermania (-7,3 %) dhe Serbia (-39,4 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2019 (%)



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 65,3 %, të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,2 %), Turqia (8,2 %), Kina (7,2 %) dhe Gjermania (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetëmujorin e parë 2019, me vendet e BE zënë 64,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Nëntor 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,7 %), Greqia (7,1 %), Kina (6,9 %) dhe Turqia (6,5 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

| Vitet | Muajt | Eksporte (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Importe (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Bilanci Tregtar (mld lekë) | Mbulimi (%) |
|-------|-------------------|------------------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -172 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -296 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -302 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| 2017 | | 273 | 12,1 | 626 | 8,1 | -353 | 43,6 |
| 2018 | | 310 | 13,7 | 641 | 2,4 | -331 | 48,4 |
| 2017 | 01 - 17 | 19 | 15,6 | 35 | 0,9 | -16 | 53,8 |
| | 02 - 17 | 20 | 14,2 | 44 | 5,1 | -24 | 45,7 |
| | 03 - 17 | 24 | 22,0 | 54 | 14,9 | -30 | 43,8 |
| | 04 - 17 | 24 | 13,7 | 50 | -3,9 | -26 | 48,1 |
| | 05 - 17 | 24 | 18,2 | 56 | 7,4 | -31 | 43,6 |
| | 06 - 17 | 23 | -0,1 | 57 | 9,2 | -34 | 39,7 |
| | 07 - 17 | 25 | 9,9 | 55 | 9,6 | -30 | 45,1 |
| | 08 - 17 | 18 | 12,3 | 49 | 6,2 | -31 | 37,4 |
| | 09 - 17 | 24 | 17,0 | 53 | 10,9 | -29 | 45,1 |
| | 10 - 17 | 25 | 14,5 | 58 | 15,5 | -33 | 43,1 |
| | 11 - 17 | 25 | 11,1 | 55 | 10,4 | -29 | 46,5 |
| | Janar - Nëntor 17 | 251 | 13,2 | 565 | 8,0 | -314 | 44,4 |
| 2018 | 01 - 18 | 24 | 24,5 | 45 | 27,5 | -21 | 52,5 |
| | 02 - 18 | 24 | 18,8 | 46 | 4,4 | -22 | 52,0 |
| | 03 - 18 | 27 | 14,6 | 55 | 2,5 | -28 | 49,0 |
| | 04 - 18 | 27 | 11,3 | 53 | 5,2 | -26 | 50,9 |
| | 05 - 18 | 30 | 24,3 | 57 | 2,1 | -27 | 53,1 |
| | 06 - 18 | 27 | 18,1 | 54 | -4,6 | -28 | 49,2 |
| | 07 - 18 | 27 | 8,2 | 58 | 6,0 | -31 | 46,0 |
| | 08 - 18 | 20 | 10,8 | 48 | -2,3 | -28 | 42,4 |
| | 09 - 18 | 26 | 8,9 | 51 | -4,4 | -25 | 51,4 |
| | 10 - 18 | 30 | 21,3 | 58 | 1,2 | -28 | 51,7 |
| | 11 - 18 | 27 | 7,0 | 56 | 2,7 | -29 | 48,4 |
| | Janar - Nëntor 18 | 289 | 15,1 | 581 | 2,8 | -293 | 49,7 |
| 2019 | 01 - 19 | 22 | -7,3 | 42 | -6,2 | -20 | 51,9 |
| | 02 - 19 | 23 | -5,3 | 50 | 8,5 | -27 | 45,4 |
| | 03 - 19 | 28 | 2,7 | 56 | 1,4 | -28 | 49,6 |
| | 04 - 19 | 27 | 0,1 | 57 | 8,9 | -30 | 46,7 |
| | 05 - 19 | 28 | -8,0 | 59 | 4,0 | -31 | 47,0 |
| | 06 - 19 | 26 | -4,1 | 53 | -1,4 | -28 | 47,9 |
| | 07 - 19 | 28 | 3,7 | 60 | 2,7 | -32 | 46,4 |
| | 08 - 19 | 20 | -1,8 | 52 | 7,1 | -32 | 38,8 |
| | 09 - 19 | 25 | -4,9 | 52 | 2,3 | -27 | 47,8 |
| | 10 - 19 | 27 | -10,2 | 59 | 1,8 | -32 | 45,6 |
| | 11 - 19 | 25 | -9,1 | 53 | -5,8 | -28 | 46,7 |
| | Janar - Nëntor 19 | 277 | -4,1 | 593 | 2,1 | -317 | 46,6 |

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|-----------------------|---------------|---------------|-----------------|-----------------|---------------|---------------|-----------------|-----------------|
| | Nëntor 2018 | Nëntor 2019 | Jan,- Nën, 2018 | Jan,- Nën, 2019 | Nëntor 2018 | Nëntor 2019 | Jan,- Nën, 2018 | Jan,- Nën, 2019 |
| Vendet e BE-së | 20.839 | 19.360 | 220.562 | 211.924 | 32.934 | 31.347 | 356.482 | 347.345 |
| Austri | 225 | 134 | 1.715 | 1.683 | 552 | 544 | 6.117 | 6.300 |
| Mbretëri e Bashkuar | 72 | 65 | 1.082 | 678 | 463 | 421 | 5.315 | 5.085 |
| Gjermani | 1.198 | 1.199 | 12.532 | 13.186 | 4.500 | 4.241 | 45.035 | 41.748 |
| Greqi | 1.109 | 1.126 | 12.259 | 11.772 | 3.816 | 3.743 | 47.001 | 50.418 |
| Itali | 13.532 | 11.794 | 138.693 | 133.680 | 14.676 | 13.934 | 160.572 | 151.073 |
| Spanjë | 1.835 | 2.528 | 22.665 | 20.590 | 1.346 | 924 | 15.245 | 10.320 |
| Kroaci | 67 | 105 | 824 | 1.027 | 580 | 693 | 5.943 | 6.440 |
| Të tjera të BE-së | 2.801 | 2.409 | 30.792 | 29.308 | 7.001 | 6.848 | 71.253 | 75.960 |
| Kinë | 580 | 523 | 5.277 | 5.864 | 5.123 | 5.084 | 48.228 | 54.459 |
| Kosovë | 2.529 | 2.287 | 24.953 | 27.607 | 710 | 509 | 8.086 | 7.133 |
| Maqedonia e Veriut | 717 | 776 | 7.957 | 7.838 | 834 | 716 | 8.739 | 7.835 |
| Rusi | 28 | - | 62 | 75 | 490 | 574 | 11.719 | 10.486 |
| SHBA | 473 | 222 | 4.786 | 3.412 | 555 | 646 | 8.179 | 11.137 |
| Turqi | 142 | 170 | 2.025 | 1.916 | 4.843 | 6.207 | 48.542 | 54.813 |
| Ukrainë | 37 | 29 | 239 | 157 | 404 | 185 | 2.887 | 2.749 |
| Zvicër | 50 | 64 | 2.864 | 843 | 956 | 1.514 | 8.455 | 14.395 |
| Të tjera | 1.785 | 1.280 | 20.069 | 17.217 | 9.297 | 6.118 | 80.069 | 83.145 |
| Gjithsej | 27.179 | 24.709 | 288.795 | 276.852 | 56.146 | 52.900 | 581.386 | 593.496 |

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---------------------------------|---------------|---------------|-----------------|-----------------|---------------|---------------|-----------------|-----------------|
| | Nëntor 2018 | Nëntor 2019 | Jan,- Nën, 2018 | Jan,- Nën, 2019 | Nëntor 2018 | Nëntor 2019 | Jan,- Nën, 2018 | Jan,- Nën, 2019 |
| Gjithsej | 27.179 | 24.709 | 288.795 | 276.852 | 56.146 | 52.900 | 581.386 | 593.496 |
| Ushqime. pije. duhan | 3.470 | 3.422 | 29.739 | 32.498 | 7.891 | 8.337 | 96.931 | 100.093 |
| Minerale. lëndë djegëse. en.el. | 3.676 | 4.167 | 53.257 | 45.582 | 7.402 | 5.915 | 60.622 | 71.083 |
| Produkte kimike dhe plastike | 564 | 629 | 5.732 | 7.173 | 6.819 | 7.113 | 79.618 | 80.935 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 179 | 230 | 2.528 | 2.283 | 1.614 | 1.475 | 17.408 | 16.076 |
| Prodhime druri dhe letre | 1.440 | 896 | 8.899 | 8.854 | 2.144 | 2.476 | 23.101 | 23.921 |
| Tekstile dhe këpucë | 11.019 | 9.631 | 114.863 | 110.285 | 8.097 | 7.902 | 80.707 | 80.295 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 4.518 | 3.304 | 49.599 | 42.112 | 6.367 | 5.599 | 71.308 | 72.972 |
| Makineri. pajisje dhe pj. këmb. | 1.601 | 1.681 | 16.612 | 19.765 | 13.485 | 11.820 | 128.678 | 125.425 |
| Të tjera | 712 | 749 | 7.567 | 8.300 | 2.328 | 2.264 | 23.014 | 22.696 |

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

| | Itali | | Kosovë | | Spanjë | | Gjermani | |
|--|----------------|----------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| Gjithsej | 138.693 | 133.680 | 24.953 | 27.607 | 22.665 | 20.590 | 12.532 | 13.186 |
| Ushqim. pije duhan | 7.469 | 7.943 | 2.560 | 3.288 | 1.166 | 1.189 | 1.366 | 1.579 |
| Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike | 4.348 | 4.867 | 6.131 | 6.489 | 17.943 | 16.835 | 1.833 | 829 |
| Produkte kimike dhe plastike | 1.509 | 1.910 | 1.212 | 2.009 | 54 | 49 | 36 | 68 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 1.843 | 1.922 | 9 | 5 | 243 | 204 | 11 | 12 |
| Prodhime druri dhe letre | 6.409 | 5.906 | 443 | 820 | 6 | 4 | 149 | 166 |
| Tekstile dhe këpucë | 88.466 | 85.724 | 107 | 107 | 3.051 | 2.102 | 6.396 | 7.019 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 16.048 | 12.559 | 12.487 | 12.599 | 160 | 195 | 874 | 1.352 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 9.092 | 9.361 | 771 | 687 | 32 | 8 | 1.319 | 1.422 |
| Të tjera | 3.510 | 3.487 | 1.232 | 1.603 | 11 | 5 | 549 | 739 |

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

| | Itali | | Turqi | | Kinë | | Greqi | |
|--|----------------|----------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| Gjithsej | 160.572 | 151.073 | 48.542 | 54.813 | 48.228 | 54.459 | 47.001 | 50.418 |
| Ushqim. pije duhan | 16.115 | 17.731 | 5.122 | 4.987 | 601 | 725 | 13.775 | 14.418 |
| Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike | 10.706 | 7.443 | 690 | 5.130 | 7 | 7 | 7.203 | 10.875 |
| Produkte kimike dhe plastike | 17.138 | 16.971 | 7.433 | 7.404 | 4.608 | 5.141 | 7.012 | 7.029 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 13.529 | 12.766 | 286 | 249 | 698 | 712 | 51 | 28 |
| Prodhime druri dhe letre | 6.779 | 6.406 | 3.092 | 3.101 | 1.030 | 973 | 3.156 | 3.270 |
| Tekstile dhe këpucë | 39.177 | 37.804 | 15.429 | 16.417 | 9.787 | 10.756 | 3.413 | 3.380 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 19.251 | 17.428 | 7.145 | 9.561 | 6.323 | 8.520 | 8.027 | 7.586 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 32.518 | 29.543 | 7.097 | 6.064 | 20.246 | 22.322 | 2.716 | 2.444 |
| Të tjera | 5.360 | 4.983 | 2.248 | 1.901 | 4.928 | 5.301 | 1.648 | 1.388 |

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(±) deri